

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR

“KOPSHTARI”

Kodi: PK-H-2-20

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“KOPSHTARI”

(PK-H-2-20)

I. Profili Profesional i Kopshtarit

a) *Karakteristikat e kopshtarit*

Kopshtari është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në ferma bujqësore apo kompani private me drejtim kopshtarie.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, Kopshtari duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të kultivuesit të kulturave kopshtare.

Suksesi i tij është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e kopshtarit*

Profesioni i Kopshtarit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e punimeve bujqësore për të kultivuar dhe vjelë kulturat kopshtare. Ata prodhojnë një shumëllojshmëri të kulturave kopshtare për shitje, ruajnë, shesin, shpërndajnë apo kryejnë marketing të produkteve të tyre për treg, si dhe prodhimin, tregtimin dhe mirëmbajtjen e bimëve peizazhore.

Ata mund të punësohen në kompani, në parqe, lulishte, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohen.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë kopshtari mund të përparojë profesionalisht në nivelin e kultivuesit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një kopshtar mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm i kopshtarisë. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e agronomit. kopshtarit

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e kopshtarisë, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Kopshtarë, kultivues të kopshtarisë dhe fidanëve” me kod 6114, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: kultivuesi i kopshtarisë dhe fidanëve, kryen veprimtaritë e nevojshme për mbjelljen, kultivimin, shtimin, trajtimin dhe mirëmbajtjen e fidanëve, të luleve, pemëve apo bimëve të tjera dekorative, të prodhimeve të kopshtarisë, të fidanishteve për shitje apo përdorime vetjake.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Kopshtari

Në përfundin të kursit për Kopshtari, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për punime në kopshtari.
- Realizojnë organizimin e vogël të punës në një fermë të vogël me drejtim kopshtarie.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.

- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, instrumentat, makineritë dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- Projektojnë modele të thjeshta kopshti.
- Zbatojnë teknikat e ngritjes dhe sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbërta.
- Zbatojnë agroteknologjinë e kultivimit të kulturave kopshtare.
- Mirëmbajnë kopshtet dhe hapësirat e gjelbëra.
- Realizojnë kompozime me lule natyrale të freskëta dhe të thata.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të kopshtarisë.
- Zbatojnë standardet e profesionit të kultivuesit të kulturave kopshtare.
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Kopshtari

Pjesmarrësit në kursin për Kopshtari duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Kopshtari

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për Kopshtari

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e kopshtarit.	MK-14-211-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kopshtarit. 2. Kursanti përshkruan cilësitë e tokës për mbjelljen e kulturave kopshtare. 3. Kursanti përshkruan elementët e projektimit të kopshtit dhe hapësirave të gjelbëra. 4. Kursanti përshkruan karakteristikat dhe agroteknologjinë e kulturave kopshtare. 5. Kursanti përshkruan shërbimet që kryhen në kulturat kopshtare. 6. Kursanti përshkruan rregullat e mbrojtjes në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve në kopshtari.
2	Teknikat e ngritjes dhe sistemimit estetik të kopshtit/	MK-14-212-20	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatitet për ngritjen e kopshtit. 2. Kursanti projektton modele të thjeshta të kopshti.

	hapësirave të gjelbëra		80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 3. Kursanti zbaton teknikën e ngritjes së kopshtit. 4. Kursanti kryen punime përgatitore për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra. 5. Kursanti kryen punime të strukturimit të kopshtit /hapësirave të gjelbëra. 6. Kursanti kryen sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
3	Agroteknologjia e kulturave kopshtare	MK-14-213-20	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përgatit tokën për mbjelljen e kulturave kopshtare. 2. Kursanti mbjell kulturat kopshtare. 3. Kursanti kryen shërbimet agroteknike në kulturat kopshtare.
4	Mirëmbajtja e kopshteve/hapësirave të gjelbërta	MK-14-214-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti pastron kopshtin/hapësirat e gjelbëra. 2. Kursanti kosit barin në kopsht/hapësirë të gjelbër. 3. Kursanti krasit kulturat kopshtare dhe dekorative në hapësirat e gjelbra
5	Kompozimi me lule natyrale të freskëta dhe të thara	MK-14-215-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kompozon buqeta me lule natyrale të freskëta. 2. Kursanti kompozon me lule natyrale të freskëta në vazo. 3. Kursanti kompozon me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Kopshtari:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e kopshtarit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E KOPSHTARIT	MK-14-211-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të kopshtarit, cilësitë e tokës bujqësore, elementët e projektimit të kopshtit/ hapësirave të gjelbra, karakteristikat kryesore dhe agroteknologjinë e kultivimit të kulturave kopshtare, rëndësinë e kryerjes së shërbimeve në kulturat kopshtare si dhe rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve në kopshtari.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kopshtarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së kopshtarit.– Të përshkruajë kërkesat profesionale për kultivuesit e kulturave kopshtare.– Të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të kopshtarit.– Të përshkruajë ngritjen dhe funksionimin e një ekonomie bujqësore me drejtim kopshtari.– Të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdorin kopshtarët.– Të përshkruajë dokumentacionin teknik që përdoret në kopshtari.– Të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.– Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit në punë.– Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve në kopshtari. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Pyetje përgjigje me gojë.– Pyetje përgjigje me shkrim	

RM 2 Kursanti përshkruan cilësitë e tokës për mbjelljen e kulturave kopshtare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë tokën bujqësore, morfologjinë dhe profilin e saj.
- Të përshkruajë lëndën organike në tokë, burimet, përbërësit e humusit në tokë dhe masat agroteknike për përmirësimin e strukturës së tokës.
- Të përshkruajë koloidet e tokës, aftësinë thithëse të koloideve dhe llojet e thithjes.
- Të shpjegojë reaksionin (ph) e tokave dhe mënyrat për përmirësimin e tij, si dhe aftësinë buferike të tokave.
- Të interpretojë veçoritë e përgjithshme të tokës, si dhe veçoritë fiziko-mekanike të saj.
- Të përshkruajë përbërjen mekanike e kimike të tokës.
- Të klasifikojë tokat sipas kriterit empirik, agrojgeologjik dhe gjenetiko-agronomik.
- Të përshkruajë hapat teknologjike të punimeve bazë dhe sipërfaqësore të tokës.
- Të përshkruajë hapat teknologjike të plehërimit organik e kimik, plehërimit të lëngshëm, plehërimit të gjelbër e bakterial.
- Të përshkruajë hapat teknologjike të kullimit, sistemimit dhe ujitjes së tokave bujqësore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan elementët e projektimit të kopshtit dhe hapësirave të gjelbërta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë rolin e faktorëve klimatik të zonës ku do të ngrihet kopshti/ hapësirë e gjelbër.
- Të përshkruajë pozicionin, vendosjen dhe madhësinë e kopshtit/ hapësirave të gjelbra.
- Të përshkruajë format e mbajtjes së kopshtit/ hapësirës së gjelbër.
- Të përshkruajë llojet e kopshteve tradicionale dhe moderne.
- Të analizojë llojet e bimësisë për tu mbjellë në kopsht/ hapësirë të gjelbra.
- Të shpjegojë shkallën e zvogëlimit dhe zmadhimit të për ngritjen e një kopshti/ hapësirë të gjelbër.
- Të shpjegojë dhe interpretojë skicat për ngritjen e kopshteve/ hapësirave të gjelbra të ndryshme.
- Të shpjegojë elementët strukturorë të skicimit të një kopshti/ hapësirë të gjelbër.

- Të përshkruajë rëndësinë e parcelizimit të sipërfaqes së tokës për ngritjen e kopshtit.
- Të përshkruajë rradhën e projektimit dhe modelimit të kopshtit/hapësirës së gjelbër.
- Të përshkruajë planin dhe strukturën e mbjelljes së bimëve në kopsht/hapësirë të gjelbër.
- Të tregojë rolin e përdorimit të TIK-ut për modelimin e kopshteve/hapësirave të gjelbëra.
- Të përshkruajë dokumentacionin teknik dhe financiarë që përdoret gjatë projektimit të një kopshti/hapësirave të gjelbëra.
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale gjatë projektimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë projektimit të një kopshti/hapësirave të gjelbëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan karakteristikat dhe agroteknologjinë e kulturave kopshtare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të kopshtarisë në mjedis dhe në jetën e njeriut.
- Të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme të secilit grup të kulturave kopshtare (një, dy dhe shumëvjeçare).
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të kulturave kopshtare zbukuruese (një, dy dhe shumëvjeçare).
- Të përshkruajë agroteknologjinë e bimëve zbukuruese qepore, zhardhokore dhe rizomatore, si gladiola, lulepatatja, narciza, shpatorja, zambaku (*Lilium*), zymbyli, kalla.
- Të përshkruajë agroteknologjinë e bimëve zbukuruese shkurre (trëndafili), si dhe pemëve gjethe dhe halore.
- Të përshkruajë agroteknologjinë kulturave të arave si patatja, fasulja, luledielli, misrit të ëmbël për gatim kikirikut për fara etj., që mund të mbillen në kopsht.
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kulturave frutore në kopsht të tilla si hardhia, kulturat farore e bërthamore, fruta të vegjël si luleshtrydhe, manaferra, boronicë etj..
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kulturave perimore.
- Të përshkruajë agroteknologjinë e kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të përshkruajë agroteknologjinë e bimëve zbukuruese të destinuara për prerje si karafili, trandafili, gardenja, zambaku i bardhë, gladiola, tulipani, zymbyli, si dhe fiere, asparagus, për gjethe të ndryshme halore, etj..

- Të theksojë kriteret e përzgjedhjes së bimëve dhe materialeve ndihmëse (zgara metalike ose rrjeta teli e nikeluar, enë mbajtëse tip tavë, mbështjellese, letër me ngjyra të ndryshme, mbështjellëse rrjete, fjongo e lidhëse të tjera) për kompozimin e buqetave, sipas qëllimit të përdorimit të tyre.
- Të përshkruajë agroteknikën e bimëve zbukuruese për ambiente të brendshme (fikus, orkide, shqiponja, palma, çiklamini, begonia, ylli i krishtelindjes, kaktus.etj).
- Të përshkruajë rolin dhe qëllimin e shfrytëzimit të hapësirave të gjelbra, si dhe elementët përbërës të tyre.
- Të përshkruajë projekte të thjeshta për krijimin e hapësirave të gjelbra sipas qëllimit të shfrytëzimit të tyre me elementet përbërës të projektimit (linja, forma, ngjyra, tekstura, proporcioni, rregulli, përsëritja, uniteti).
- Të shpjegojë lidhjen e kopshteve dhe të hapësirave të gjelbra me ekoturizmin në ditët e sotme.
- Të përshkruajë rëndësinë e kombinimit të bimëve zbukuruese me njëra-tjetrën në hapësira të gjelbra duke ruajtur efektin e ngjyrës në mjedis.
- Të përshkruajnë mënyrën e kultivimit të barit dhe kombinimin e tij me bimët e tjera zbukuruese për krijimin e hapësirave të gjelbra.
- Të përshkruajë shërbimet që kryhen për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 5 Kursanti përshkruan shërbimet që kryhen në kulturat kopshtare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë rëndësinë e punimit të tokës, llojet e punimeve bazë dhe plotësues të tokës, si dhe procesin e realizimit të tyre.
- Të përshkruajë rëndësinë e plehërimit, llojet e plehërave organike dhe kimike, llojet e plehërimeve, si dhe procesin e realizimit të tyre.
- Të përshkruajë rëndësinë e ujitjes, cilësitë e ujit për ujitje, llojet e ujitjeve, si dhe procesin e realizimit të tyre.
- Të përshkruajë rëndësinë e mbrojtjes së kulturave kopshtare nga sëmundje dhe dëmtues, llojet kryesore të sëmundjeve dhe dëmtuesve, si dhe mënyrat kryesore të trajtimit të tyre.
- Të përshkruajë rëndësinë e vjeljes së prodhimit të kulturave kopshtare, mënyrat dhe teknikat e vjeljes në kultura të ndryshme kopshtare, si dhe grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit.
- Të përshkruajë rëndësinë e përpunimit të kulturave

- kopshtare.
- Të përshkruajë rëndësinë e magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit të kulturave kopshtare.
 - Të listojë mënyrat e tregëtimit të prodhimit të kulturave kopshtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 6 Kursanti përshkruan rregullat e mbrotjes në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve në kopshtari.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë gjatë punimeve në kopshtari;
- Të dallojë dhe shpjegojë masat e mbrojtjes në mjediset e punës së kopshtarisë;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve në kopshtari duke shpjeguar mënyrën e shmangies së tyre;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe përmbajtjen e kutisë së ndihmës së parë.
- Të përdorë drejt mjetet dhe medikamentet e ndihmës së parë.
- Të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve.
- Të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e humbjes së vetëdijes.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet në kopshtari;
- Të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zjarri.
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me vegla dore dhe makina bujqësore;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe tregëtimit të prodhimit të kopshtarisë;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e bazës prodhuese, mjedise të mbrojtura ose fushë e hapur, në ekonomi bujqësore me

drejtim kopshtarie. Rekomandohen dhe vizita në mjedise apo hapësira të tjera publike.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës së kopshtarisë. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Vegla të thjeshta dore, farë bari ose tapet bari.
 - Bimë shkurre dhe lule të ndryshme.
 - Pajisje për ujitje, kangjella për gardh, tulla, gurë, etj.
 - Mjete për ndërtim stolash çlodhës etj.
 - Plehra kimike, pesticide, dherishte, pleh organik etj.
 - Mjedis i mbrojtur dhe i hapur i përshtatshëm për kopësht.
 - Libra, broshura, fletëpalosje, kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive.
-

2. Moduli "Teknikat e ngritjes dhe sistemimit estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbërta".

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TEKNIKAT E NGRITJES DHE SISTEMIMIT ESTETIK TË KOPSHTIT/HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA	MK-14-212-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për projektimin e modeleve të thjeshta të kopshtit, zbatimin e teknikave të ngritjes reale të kopshtit, strukturimit dhe sistemimit estetik të kopshteve/hapësirave të gjelbra, si dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën "Hyrje në profesionin e kultivuesit të kulturave kopshtare".	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatitet për ngritjen e kopshtit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të kopshtarit. – Të përzgjedhë vendin për ngritjen e kopshtit, sipas kushteve klimatiko-tokësore. – Të përzgjedhë veglat, mjetet e materialet e nevojshme për ngritjen e kopshtit dhe hapësirave të gjelbërta. – Të analizojë faktorët klimatik të zonës ku do të ngrihet kopshti si temperatura, lagështira orientimi gjeografik. – Të analizojë rezultatet e analizës së përbërjes mekanike e kimike e tokës për ngritjen e kopshtit dhe hapësirave të gjelbërta. – Të përcaktojë madhësinë e kopshtit, sipas qëllimit të ngritjes së tij (familjar, park publik etj.). – Të përcaktojë formën e mbajtjes së kopshtit (tradicionale, bashkëkohore) dhe hapësirave të gjelbërta. – Të përcaktojë llojin e kopshtit (simetrik, asimetrik dhe formë e lirë, mono apo poli kulturë) dhe hapësirave të gjelbërta. – Të përcaktojë llojet e kulturave kopshtare për tu mbjellë në kopsht si: lule, perime, pemë frutore, bimë zbukuruese, bimë arash etj. – Të përcaktojë distancat e mbjelljes sipas veçorive të grup kulturave që përzgjidhen për tu mbjellë. – Të kominikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së parapërgatitjeve për ngritjen e kopshtit. – Të plotësojë dokumentacionin teknik të parapërgatitjes për ngritjen e kopshtit. 	

-
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për ngritjen e kopshtit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti projektton modele të thjeshta kopshti.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë bazën materiale për projektimin e modeleve të thjeshta të kopshtit.
- Të përcaktojë shkallën e zvogëlimit dhe të zmadhimit sipas kahut të projektimit p.sh.: 1cm në skicë t'i përgjigjet 1m në terren etj.
- Të përgatisë skicën e kopshtit, sipas parametrave të përcaktuara më parë për forma të ndryshme gjeometrike.
- Të skicojë elementët strukturorë të kopshtit si: qendrën e kopshtit, rrugët, vendet çlodhëse, radhën e mbjelljeve, kombinimi i bimëve në mbjellje etj.
- Të skicojë parcelizimin e sipërfaqes së kopshtit, në distanca që lejojnë kalimet midis tyre, në forma të ndryshme gjeometrike, t ngritura ose jo nga toka.
- Të përgatisë planin e mbjelljes për çdo parcelë të kopshtit:
 - Çfarë –lloji i bimës (lule, perime, drufrutorë, bimë zbukuruese, bimë arash etj.)
 - Ku – parcela dhe vendi i caktuar brenda në parcelë.
 - Sa – numrin e bimëve brenda llojit (sa lloje drufrutorë, perimesh, lulesh a bimë të tjera aromatike/mjekësore dhe zbukuruese).
 - Si – mënyrat e mbjelljes me shpërndarje, me rreshta, me gropa etj.
 - Kur – afatet kohore të përcaktuara të mbjelljes së tyre.
- Të shfrytëzojë software specifike kompjuterike për modelimin e kopshtit, sipas mundësive që ofrohen.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së projektimit të modeleve të thjeshta të kopshteve.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të projektimit të modeleve të thjeshta të kopshteve.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me projektimin e modeleve të thjeshta kopshtesh.
- Të plotësojë faturën financiare për projektimin e kryer.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së projektimit të modeleve të thjeshta të kopshteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Pyetje – përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti zbaton teknikën e ngritjes së kopshtit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- Të veshë uniformën e punës së kopshtarit.
- Të përgatisë veglat, materialet dhe vendin ku do të mbillen kulturat kopshtare.
- Të sigurojë materialin mbjellës të nevojshëm si fara, fidanë, copa, kalema, qepujka etj., dhe ta ruajë atë në kushtet e caktuara për ruajtjen e tyre.
- Të pastrojë vendin ku do të ngrihet kopshti nga gurët, shkurret dhe mbetjet e tjera bimore.
- Të piketojë sipërfaqen e tokës ku do të ndërtohet kopshti sipas projektit.
- Të piketojë rreshtat për mbjellje dhe distancat e bimëve brenda rreshtit, sipas projektit.
- Të transportojë me shumë kujdes materialin mbjellës si fara, fidanë, copa, kalema, qepujka etj, në parcela.
- Të mbjellë materialin mbjellës sipas veçorive të kulturave kopshtare duke respektuar planin e mbjelljes së tyre në projekt.
- Të kryejë përkujdesjet menjëherë pas mbjelljes si: ujitje, kontrolli i zënies, zëvendësimi i bimëve etj.
- Të kryejë shërbimet agroteknike gjatë ciklit bimor sipas qëllimit përfundimtar të kultivimit të tyre.
- Të pastrojë vendin pas kryerjes së punimeve të ngritjes së kopshtit.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës së ngritjes së kopshtit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të teknikës së ngritjes së kopshtit.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të ngritjes së kopshtit.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet për ngritjen e kopshtit.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknikës së ngritjes së kopshtit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen punime përgatitore për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e punës për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirës së gjelbër.
- Të përgatisë planin e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirës së gjelbër.
- Të përcaktojë sipërfaqen e kopshteve për sistemim, sipas

hapësirave të tij (zbukuruese, çlodhëse si dhe pjesa ku vendosen veglat e punës).

- Të përzgjedhë mjetet dhe veglat e punës që nevojiten për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirës së gjelbër.
- Të transportojë mjetet dhe veglat e punës sipas kërkesave teknike.
- Të interpretojë skicën e gatshme për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirës së gjelbër, sipas modeleve të dhëna.
- Të skicojë kopshtin/hapësirën e gjelbër me përmasa së bashku me objektet dhe gjelbërimin ekzistues.
- Të marrë mostrën e tokës për analizë për të përcaktuar llojin e tokës.
- Të përcaktojë llojin e bimësisë (bar, bimësi e ulët, shkurre dhe drurë) që do të përdoret për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra, sipas modeleve të dhëna.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve përgatitore për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të sistemimit estetik të kopshteve/hapësirave të gjelbëra.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore të sistemimit estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti kryen punime të strukturimit të kopshtit/hapësirës së gjelbër

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- Të veshë uniformën e punës për kryerjen e punimeve të strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të përgatisë siç duhet planin e punimeve të strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të përcaktojë vendet ku do të bëhen punimet e nëndheshme dhe të mbidheshme si: drenazhimi, sistemi elektrik dhe i gazit, sistemi i ujitjes, rrugicat dhe rrethimi i kopshtit sipas teknologjisë që i përshtatet kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet që nevojiten për kryerjen e drenazhimit, sistemit elektrik e gazit, sistemi i ujitjes, rrugicat dhe rrethimi i kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të hapë kanalet drenazhuese brenda kopshtit me rënie 60 - 90 cm për çdo 100 m tokë horizontale.
- Të montojë sistemin e ujitjes brenda kopshtit/hapësirave të

- gjelbëra sipas mënyrës që i përshtatet (me rubinet e tub gome, në formë shiu dhe me pika etj.).
- Të ndërtojë rrugicat brenda kopshtit sipas skemës së dhënë duke përdorur gurë, guriçka, tulla, pllaka të parafabrikuara, pllaka me vrima ku në mesin e tyre mbillet bar i gjelbër, dru ose dërrasa, granil, zhavor etj.
 - Të ndërtojë vendet çlodhëse brenda kopshtit dhe tenda me bimë të gjelbëra.
 - Të rrethojë kopshtin me mur ose gardh.
 - Të kontrollojë punimet e kryera për strukturimin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të përmirësojë cilësinë e punimeve të strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra sipas rastit.
 - Të mbajë saktë shënimet për punimet e kryera gjatë strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të pastrojë vendin e punës pas kryerjes së punimeve të strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të kujdeset dhe mirëmbajnë veglat dhe materialet e strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve të strukturimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të plotësojë dokumentacionin teknik të punimeve për strukturimin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet për strukturimin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
 - Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për strukturimin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 6 Kursanti kryen sistemimin estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë të aftë:

- Të veshë uniformën e duhur të punës për kryerjen e sistemimit estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të përzgjedhë vegla, pajisjet dhe materialet e nevojshme për sistemimin estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të përgatisë siç duhet planin e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të interpretojë skicën e gatshme të dhënë për sistemimin estetik të kopshtit dhe hapësirave të gjelbëra.
- Të përzgjedhë kulturat kopshtare sipas skemës së dhënë.
- Të mbjellë barin e fortë në lëndinë sipas skemës së dhënë.
- Të mbjellë kulturat kopshtare sipas skemës së dhënë.

- Të kryejë shërbimet e menjëhershme pas mbjelljes (ujitje, sistem mbështetës, capitje etj.).
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të kryera për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Të përmirësojë cilësinë e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të mbajë saktë shënimet për punimet e kryera gjatë sistemimit estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të pastrojë vendin e punës pas kryerjes së punimeve të sistemimit estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të kujdeset ndaj veglave dhe materialeve të sistemimit estetik të kopshtit dhe hapësirave të gjelbërta.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve të sistemimit estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për sistemimin estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet për sistemimin estetik të kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për sistemimin estetik të kopshtit/hapësirave të gjelbëra

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli
-

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në një mjedis të përshtatshëm në kopshte apo hapësira të gjelbra.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur projekte dhe skica të gatshme të sistemimit estetik të kopshteve, si dhe demonstrime konkrete të proceseve për sistemimin estetik të tij.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për ngritjen e kopshtit, projektimin e modeleve të thjeshta, kryerjen e veprimeve për strukturimin dhe sistemimin estetik të kopshtit fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Kursantët duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të proceseve të punës për për ngritjen e kopshtit, projektimin e modeleve të thjeshta, kryerjen e veprimeve për strukturimin dhe sistemimin estetik të kopshtit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë edhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për për ngritjen e kopshtit, projektimin e modeleve të thjeshta, kryerjen e veprimeve për strukturimin dhe sistemimin estetik të kopshtit.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të punës.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi

i shkallës së arritjes së shprehive praktike për për ngritjen e kopshtit, projektimin e modeleve të thjeshta, kryerjen e veprimeve për strukturimin dhe sistemimin estetik të kopshtit si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme:

- Mjedisi për kopshtin.
 - Vegla dhe pajisje pune për sistemimin estetik të kopshtit.
 - Pankarta, projekte dhe skica të gatshme, udhëzues, katalogë etj.
 - Farë bari ose tapet bari.
 - Bimësi e ulët (lule të ndryshme) sipas skemave.
 - Bimë shkurre sipas skemave.
 - Pajisje për ujitje, kangjella për gardh, tulla, gurë, guriçka etj.
 - Mjete për ndërtim stolash çlodhës etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualët e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit sistemimin estetik të kopshtit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

3. Moduli “Agroteknologjia e kulturave kopshtare”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	AGROTEKNOLOGJIA E KULTURAVE KOPSHTARE	MK-14-213-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të kryer zbatuar të gjithë hapat teknologjik të kultivimit të kulturave kopshtare si: përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave kopshtare, mbjelljen, shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetacionit, si dhe llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e kopshtarit” dhe “Teknikat e ngritjes dhe sistemimi estetik i kopshtit/hapësirave të gjelbërta”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit tokën për mbjelljen e kulturave kopshtare. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse gjatë punimeve për përgatitjen e tokës.– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave kopshtare.– Të kryejë kontrollin teknik vizual të zakonshëm të veglave dhe mjeteve të punës për punimin e tokës.– Të bëjë përshtatjen e veglave dhe mjeteve të punës sipas llojit të punimit.– Të kryejë plehërimin bazë të tokës me plehra organike dhe minerale, sipas dozave përkatëse.– Të kryejë punimin bazë dhe plotësues të tokës me vegla të thjeshta ose të mekanizuara.– Të kontrollojë cilësinë e punimit bazë dhe plotësues të tokës.– Të pastrojë veglat dhe mjetet e punës pas përdorimit të tyre.– Të kujdeset për veglat, pajisjet dhe materialet e punës gjatë dhe pas përdorimit të tyre.– Të plotësojë dokumentacionin teknik për punimet e tokës.– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me punimet e kryera.– Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjes së tokës për mbjelljen e kulturave kopshtare.– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së	

mjedisit gjatë përgatitjes së tokës për mbjelljen e kulturave kopshtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti mbjell kultura kopshtare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e duhur të punës gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e kulturave kopshtare.
- Të përcaktojë vendin për mbjelljen e kulturave kopshtare, sipas kërkesave të tyre.
- Të përcaktojë saktë radhën e punës për mbjelljen e kulturave kopshtare.
- Të përcaktojë format e rregullta gjeometrike të mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të përcaktojë llojet e kulturave kopshtare që do të mbillen.
- Të llogarisë sasinë e materialit mbjellës (farë, fidanë, copa).
- Të përcaktojë distancat e mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të kryejë piketimin e vendit për mbjelljen e kulturave kopshtare.
- Të zbatojë planin e mbjelljes së kulturave kopshtare duke respektuar distancat dhe kompozimin e mbjelljes së tyre në forma sipas modelit.
- Të kryejë hapjen e vijave ose gropave për mbjellje, sipas llojit të kulturave kopshtare.
- Të kryejë mbjelljen e kulturave kopshtare, sipas planit, formës së caktuar dhe distancave të mbjelljes për çdo kulturë të zgjedhur për tu mbjellë.
- Të pastrojë vendin, gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me mbjelljen e kulturave kopshtare.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen shërbimet agroteknike në kulturave kopshtare.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për kryerjen e shërbimeve pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të përcakton llojin e kulturës ku do të kryhen shërbimet agroteknike pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit.
- Të përcaktojë radhën e punës për shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të kryejë shërbimet menjëherë pas mbjelljes së kulturave kopshtare si: ujitje, capitje, kontrolli i mbirjes etj.
- Të kryejë shërbimet agroteknike gjatë periudhës së vegetacionit: ujitje, prashitje, rrallime, plehrime, etj.
- Të vëzhgojë mjedisin e kopshtit dhe të hapësirave të gjelbëra për sëmundje e dëmtues.
- Të identifikojë bimët e prekura nga sëmundje apo dëmtues gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të diagnostikojë sëmundjen apo dëmtuesin në bimët e prekura.
- Të përcaktojë masat e luftimit të sëmundjeve apo dëmtuesve (masa agroteknike, mekanike, kimike apo biologjike).
- Të kryejë trajtimin kimik të kulturave kopshtare për sëmundje dhe dëmtues.
- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së shërbimeve në kulturat kopshtare.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë shërbimeve pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të mbajë saktë shënime gjatë shërbimeve pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë shërbimeve pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë shërbimeve pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegetacionit të kulturave kopshtare.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.

- të zbatohet rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë shërbimeve pas mbjelljes dhe gjatë vegjetacionit të kulturave kopshtare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në ngastra të vogla në bazën prodhuese të qendrës ose në zonat përreth.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për zbatimin e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave kopshtare si: përgatitja e tokës për mbjellje, mbjelljen e kulturave kopshtare, shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetacionit, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave të ndryshme kopshtare si: përgatitja e tokës për mbjellje, mbjelljen e kulturave kopshtare, shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetacionit, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.
- Kursantët duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave të ndryshme kopshtare si: përgatitja e tokës për mbjellje, mbjelljen e kulturave kopshtare, shërbimet pas mbjelljes dhe gjatë vegjetacionit, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve për kryerjen e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave të ndryshme kopshtare.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerisë dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kultivimin e kulturave kopshtare në kopsht, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet ngastra e tokës bujqësore, veglat, pajisjet, dhe makineria e mëposhtme:

- Mjedisi për kopsht dhe hapësira të gjelbëra publike.
 - Vegla dhe pajisje pune të kultivimit të kulturave kopshtare.
 - Material mbjellës të kulturave kopshtare.
 - Farë bari ose tapet bari
 - Plehëra organike e kimike.
 - Enë apo mekanizma për ujtitje.
 - Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
-

-
- Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit të tokave bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

4. Moduli “Mirëmbajtja e kopshteve/hapësirave të gjelbërta”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MIRËMBAJTJA E KOPSHTEVE/ HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA	M-14-214-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të kryer punime të pastrimit të mjedisit, kositjes së barit, mirëmbajtjes së kurorës, mbrojtjes së bimëve dekorative e pemëve në kopsht/hapësirave të gjelbëra, si dhe të kryerjes së llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e kopshtarit” dhe “Agroteknologjia e kulturave kopshtare”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti pastron kopshtin/ hapësirat e gjelbra. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none">– Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për pastrimin e kopshtit/ hapësirave të gjelbëra.– Të vëzhgojë mjedisin e kopshtit/ hapësirave të gjelbëra për pastrimin e tij.– Të përzgjedhë mjetet dhe veglat e nevojshme të punës për pastrimin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra (fshesa, krëhëra, thasë, karroca dore etj.)– Të transportojë mjetet dhe veglat të punës në kopsht/hapësirë të gjelbër.– Të përcaktojë kohën e kryerjes së pastrimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra (mëngjes ose mbrëmje).– Të pastrojë mjedisin e kopshtit/hapësirave të gjelbra duke grumbulluar mbetjet bimore si gjethe, degë, lule etj.– Të kryejë largimin e mbeturinave bimore nga kopshti/hapësirave të gjelbëra në vendin e grumbullimit të tyre (fundit i kopshtit për kompostimin e tyre etj.).– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë pastrimit të kopshtit/hapësirave të gjelbra.– Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë pastrimit të kopshtit/hapësirave të gjelbra.– Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike në lidhje me pastrimin e kopshtit/hapësirave të gjelbra.– Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të kopshtit/hapësirave të gjelbra. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Pyetje-përgjigje me gojë

RM 2 Kursanti kosit barin në kopsht/hapësirë të gjelbër.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jenë të aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për kositjen e barit në kopsht/hapësira të gjelbëra.
- Të përzgjedhë mjetet dhe veglat e nevojshme të punës për kositjen e barit në kopshte/hapësira të gjelbëra.
- Të transportojë mjetet dhe veglat të punës në kopsht/hapësira të gjelbëra.
- Të përcaktojë kohën e kryerjes së kositjes së barit në kopsht/hapësira të gjelbëra.
- Të kositë barin me kosë në kopsht/hapësirë të gjelbër, sipas kriterëve të caktuara.
- Të kositë barin me motokorrëse në kopsht/hapësira të gjelbra.
- Të grumbullojë barin e kositur në kopsht/ hapësira të gjelbra, në grumbuj të vegjël.
- Të largojë barin e grumbulluar me krah ose mjete mekanike nga kopshti/hapësirat e gjelbëra.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kositjes së barit në kopsht dhe në hapësira të gjelbëra.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë kositjes së barit në kopsht dhe në hapësira të gjelbëra.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike në lidhje me kositjen e barit në kopsht/hapësira të gjelbëra.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kositjes së barit në kopsht/hapësira të gjelbëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti krasit kulturat kopshtare dhe dekorative në hapësirat e gjelbra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jenë të aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për krasitjen e kulturave kopshtare/hapësirat e gjelbëra.
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e nevojshme të mirëmbajtjes së formave të bimëve zbukuruese dhe pemëve, në kopsht/ hapësira të gjelbëra.
- Të identifikojë bimët dekorative dhe pemët për krasitjen e tyre.
- Të përcaktojë formën e kurorës në figura të rregullta gjeometrike si: katrore, rrethore, katrore e shkallëzuar, imitim i formave të kafshëve etj, si dhe në formë të lirë të

- rritjes së tyre, ndërsa pemët frutore të mbahen në formë kupore, palmetë etj.
- Të kryejë krasitjen dimërore të bimëve zbukuruese dhe pemëve, në formën e caktuar të kurorës në përputhje me llojin e bimës.
 - Të realizojë krasitje vegjetative të bimëve zbukuruese dhe pemëve, për një ajrim dhe ndriçim më të mirë të kurorës së bimëve zbukuruese dhe pemëve.
 - Të grumbullojë dhe largojë mbetjet bimore gjatë krasitjes nga kopshti/hapësirave të gjelbëra.
 - Të vendosë sistem mbështetës për mbajtjen e degëve të bimë zbukuruese dhe pemëve sipas nevojës së tyre.
 - Të zbatojë format më të përshtatshme të ujitjes së bimëve dhe pemëve në kopsht e në hapësira të gjelbëra, sipas kërkesave dhe nevojave të bimëve.
 - Të kryejë pastrimin dhe ruajtjen e mjedisit gjatë krasitjes së kulturave kopshtare.
 - Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krasitjes së bimëve dekorative dhe pemëve në kopsht/hapësira të gjelbëra.
 - Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë krasitjes së bimëve dekorative dhe pemëve në kopsht/hapësira të gjelbëra.
 - Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike në lidhje me krasitjes e bimëve dekorative dhe pemëve në kopsht/hapësira të gjelbëra.
 - Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
 - Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë krasitjes së bimëve dekorative dhe pemëve në kopsht/ hapësira të gjelbëra.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kopshte dhe në hapësira të gjelbra të qytetit apo komunës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të punimeve për mirëmbajtjen e kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për pastrimin, kositjen e barit, mirëmbajtjes e kurorës, dhe mbrojtjen e bimëve dhe pemëve të kopshtit/hapësirave të gjelbëra, fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.
- Kursantët duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të punimeve të mirëmbajtjes së kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë dhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes së kopshtit/hapësirave të gjelbëra.

-
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes së kopshtit/hapësirave të gjelbëra.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të punimeve të mirëmbajtjes së kopshtit/hapësirave të gjelbëra, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me këto punime.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme:

- Mjedisi për kopsht dhe hapësira të gjelbëra publike.
 - Vegla dhe pajisje pune të mirëmbajtjes së kopshtit dhe të hapësirave të gjelbëra.
 - Udhëzues, katalogë të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.
 - Motokorrse, kosa.
 - Komplet i veglave të krasitjes.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-

5. Moduli “Kompozimi me lule natyrale të freskëta dhe të thara”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KOMPOZIMI ME LULE NATYRALE TË FRESKËTA DHE TË THARA	M-14-215-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për kompozimin me lule natyrale të freskëta në vazo, përdorimin e luleve të thata në shporta dhe objekte të tjera, si dhe të kryerjes së llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “ Hyrje në profesionin e kopshtarit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti kompozon buqeta me lule natyrale të freskëta. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta. – Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e nevojshme për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta. – Të përgatitë vendin për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta. – Të grumbullojë/sigurojë sasinë dhe llojshmërinë e nevojshëm të luleve natyrale të freskëta për buqeta. – Të sigurojë materiale të tjera bimore për kompozimin e buqetave si: gjethe të ndryshme, kërcenj, gipsofil etj. – Të shtrojë tavolinën e punës për kompozimin e buqetave. – Të kompozojë buqeta për raste të ndryshme si: datëlindje, kritshlindje e viti i ri, festa e nënës, e mësuesit, martesa, funerale etj. – Të vendosë materiale të tjera bimore shtesë për gjethe të ndryshme halore, fletore, gjethe bashkë me kërcëjtë dhe lulerinë e tyre etj. në buqetë, sipas një raporti të caktuar gjethe-lule. – Të lidhë lulet dhe materialet e kompozuara me lidhëse të ngjyrave e formave të ndryshme, materialeve ndihmëse (zgara metalike ose rrjeta teli e nikeluar, enë mbajtëse tip tavë, mbështjellese, letër me ngjyra të ndryshme, mbështjellëse rrjete, fjongo e lidhëse të tjera). – Të bëjë shkurtimin e bishtave të luleve të buqetës në pjesën fundore uniformisht. – Të bëjë përgatitjen përfundimtare të buqetave duke i mbështjellë me letër apo rrjeta të llojeve e ngjyrave të ndryshme, e lidhur me fjongo me forma e ngjyra të ndryshme. 	

- Të pastrojë vendin dhe mjetet e kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti kompozon buqeta me lule natyrale të freskëta në vazo.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e nevojshme për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të përgatitë vendin për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të përzgjedhë llojet dhe madhësinë e vazove për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të sigurojë lule të ngjyrave të ndryshme dhe materialeve të ndryshme vegjetative.
- Të shtrojë tavolinën e punës për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të vendosë me kujdes vazot në tavolinë.
- Të mbushë vazon me materiale të ndryshme si sfungjerë, bukë peshku, guriçka, rërë, zhavorr, mbeturina bimore etj.
- Të vendosë materialin vegjetativ dhe lulet në vazo sipas kërkesës dhe modelit të kompozuar.
- Të përcaktojë seksionet midis luleve e gjetheve sipas një raporti të drejtë midis tyre.
- Të rregullojë volumin e buqetës në vazo me gjethe të gjelbra të formave të ndryshme.
- Të bëjë përgatitjen përfundimtare e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo duke bërë zbukurimin e tyre me letër apo rrjetë dekorative.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e kompozimit të buqetave me lule natyrale në vazo.

- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kompozimit të buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kompozon me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për kompozimin me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e nevojshme për kompozimin me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të përgatitë vendin e punës për kompozimin me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të përzgjedhë llojet dhe madhësinë e shportave për kompozimin me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera, sipas kërkesës.
- Të sigurojë lule të thata të ngjyrave të ndryshme dhe materialeve të ndryshme bimore sipas modelit të kompozuar.
- Të shtrojë tavolinën e punës për kompozimin me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të vendosë me kujdes shportat në tavolinë.
- Të mbushë shportën me materiale të ndryshme si sfungjerë, bukë peshku, mbeturina bimore të thata, myshk i thatë etj.
- Të vendosë materialin bimor lulet të thara në shporta sipas kërkesës dhe modelit të kompozuar.
- Të bëjë përgatitjen përfundimtare të kompozimit me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera duke bërë zburime shtesë sipas kërkesës.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e përgatitjes së kompozimit me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kompozimit me lule të thata në shporta dhe objekte të

tjera.

- Të plotësojë dokumentacionin teknik gjatë kompozimit me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike në lidhje me kompozimin me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.
- Të plotësojë faturën financiare për punimet e kryera.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kompozimit me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në bazën prodhuese të qendrës dhe në pikat e tregëtimit të luleve natyrale të freskëta.
- Instruktori i praktikës ose specialisti i kompozimit të buqetave duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për kompozimin e luleve natyrale të freskëta në buqeta e në vazo, përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kompozimin e luleve natyrale të freskëta në buqeta,vazo, përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta e objekte të tjera.
- Kursantët duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta dhe kompozimin e buqetave me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera, si dhe në llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to
- Instruktori i praktikës ose specialisti i përgatitjes së buqetave duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për kompozimin e buqetave me lule natyrale të freskëta dhe kompozimin e buqetave me lule të thata në shporta dhe objekte të tjera, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për kompozimin e buqetave me lule.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Baza prodhuese e qendrës ose pikë tregtimi lulesh.
 - Tavolina për kompozimin e buqetave.
 - Lule natyrale të freskëta të ngjyrave të ndryshme
 - Lule të thata të ngjyrave të ndryshme.
 - Materiale bimore të ndryshme natyrale të freskëta dhe të thata.
 - Shporta në forma dhe madhësi të ndryshme.
-

-
- Mjete dhe materiale për zbulimin e buqetave si; letër e rrjetë dekorative, lidhëse të ndryshme, fjongo, kapëse, tela, fiqe, shirita zbulues etj,
 - Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde buqetash, etj.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përgatitjes së buqetave (kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal.
-